

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-083/12

**Prishtinë,
12 nëntor 2013**

Në çështjen juridike të:

S.R.

Paraqitësja e kërkesës- Pala përgjegjëse në ankesë

Kundër

B.K.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Ermenkova Filcheva, Kryetare e Kolegjit, Esma Ertezi dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur në ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/112/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 33473 e datës 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 12 nëntor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

Anulohet për shkak të mungesës së juridiksionit vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/112/2011, i datës 22 qershor 2011, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 33473, si dhe hedhet kërkesa si e papranueshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale

1. Me 30.03.2007, S. R., në cilësinë e kryefamiljarit, ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku ka kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr.1792, 1793 dhe 1794 në vendin e quajtur "Svracak", Svracaku i Ultë në Vushtrri. Kërkesa është regjistruar në AKP me numër të lëndës KPA 33473.
2. Fillimisht AKP-ja ka bërë njoftimin e pronës me 24 prill 2009 duke vendosur shenjën e cila është përsëritur përmes publikimit të njoftimit në Gazetë me 22 korrik 2010, në bazë të vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) i datës 8 mars 2010, me numër KPCC/RES/17/2010 për identifikim të saktë dhe njoftim të duhur të pronës së kërkuar.
3. Përderisa kërkesa nuk është kontestuar, KKPK-ja me 22 qershor 2011, përmes vendimit nr. KPCC/D/A/112/2011, vendosi se paraqitësi i kërkesës vërtetoi të drejtën pronësore të bartësit të së drejtës pronësore dhe miratoi kërkesën në fjalë.
4. Me 7 qershor 2012, pala ankuese, B. (Sh.) K. paraqiti ankesë duke kundërshtuar vendimin e KKPK-së.
5. Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës/palës përgjegjëse në ankesë me 30 gusht 2012. Ai ka paraqitur përgjigje në ankesë.
6. Me 6 dhjetor 2012, gjyqtari i Kolegjit të Apelit të AKP-së lëshoi një urdhër ndaj paraqitësit të kërkesës/palës përgjegjëse në ankesë duke i dhënë mundësi të jap përgjigje në ankesë. Urdhri i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës/palës përgjegjëse në ankesë me 17 dhjetor 2012; megjithatë ai nuk paraqiti përgjigje as ndaj këtij urdhri.

Përmbledhja e çështjeve faktike

7. Paraqitësi i kërkesës pretendon se babai i tij, i ndjeri P. R. ishte pronar i ngastrave kontestuese. Ai paraqiti fletën poseduese nr.1505 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Komuna e Vushtrrisë, që tregon ngastrat nr. 1792, 1793 dhe 1794 të regjistruara në emër të P. R. Kjo fletë posedues është verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.

8. KKPK-ja, duke marr parasysh se paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente që tregojnë marrëdhënien e tij me pronarin e regjistruar dhe në bazë të pretendimeve të paraqitësit të kërkesës se e kishte humbur pronësinë për shkak të rrethana të ndërlydhura me konfliktin, e miratoi kërkesën.

9. Paraqitësi i ankesës nuk morri pjesë në procedurë të shkallës së parë. Në ankesën e tij ai nuk kundërshtoi se ngastrat kontestuese ishin të regjistruara në emër të babit të paraqitësit të kërkesës. Sidoqoftë, ai pretendoi se i kanë blerë të gjitha ato ngastra nga S. (P.) R. në vitin 1996 dhe se e kanë paguar tërë çmimin në shumën prej 12000 DM. Në vazhdim pohoi se kur kanë biseduar në telefon me 30 maj 2012, kjo shitje është konfirmuar nga S.R, paraqitësi i kërkesës.

Arsyetim ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Sipas dokumenteve në dosje të AKP-së, ngastrat janë vizituar me 24 prill 2009; sidoqoftë, është vërejtur se vendosja e shenjave nuk është bërë në ngastrat e duhura kontestuese. Në bazë të vendimit të lartpërmendur të KKPK-së publikimet e njëjta janë bërë përsëri përmes gazetës në vitin 2010 me qëllim të korrigjimit të njoftimit.

11. Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parasheh se çdo person, përveç paraqitësit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesa me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive. Në bazë të kësaj, personi në fjalë duhet të informohet rreth procedurës që është iniciuar. Në rastin në fjalë, pala ankuese nuk ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në procedurë pas publikimit të kërkesës në pajtim me nenin 10.1 të

rregullores. Sidoqoftë, ai nuk mund të konsiderohet të jetë njoftuar siç duhet lidhur me procedurën në AKP, pasi që asnjë njoftim fizik nuk ka ndodhur në ngastrën e duhur, përveç përmes publikimit në Gazetë në vitin 2010. Prandaj, e drejta e tij për tu ankuar nuk është përjashtuar thjesht për këtë arsye.

12. Vendimi i KKPK-së nuk i është dorëzuar palës ankuese. Nuk ka të dhëna në dosje për datën e njoftimit të palës ankuese rreth vendimit të KKPK-së. Prandaj, ankesa duhet të konsiderohet si e afatshme dhe e pranueshme.

Juridiksioni

13. Sipas nenit 3.1 të Rregullores, KKPK-ja ka kompetencë që të zgjidh kërkesat që ndërlidhën drejtpërsëdrejti me rrethanat ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Kështu që, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm të ofrojë dëshmi rreth pronësisë ndaj pronës së paluajtshme por gjithashtu edhe të tregojë pamundësinë e tij të ushtrojë atë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhën drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur. Të dyja këto kushte duhet të plotësohen.

14. Në rastin në fjalë, paraqitësi i kërkesës S. R. paraqiti një fletë poseduese që tregon se toka është e regjistruar në emër të paraardhësit të tij siç është verifikuar nga AKP-ja. Megjithatë, me parashtrim të ankesës çështja u bë kontestuese. Pala ankuese B.K. pretendon ta ketë blerë pronën e përmendur në vitin 1996. Paraqitësi i kërkesës nuk paraqiti asnjë kundër-argument apo provë për të dëshmuar se posedimi ishte humbur në rrethana që ndërlidhën drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/1999. Shitja nuk është kontestuar nga paraqitësi i kërkesës/ pala përgjegjëse në ankesë edhe pse dy herë i është ofruar mundësia të përgjigjet ndaj pretendimeve të palës ankuese. Kështu, ai nuk paraqiti përgjigje në ankesë e as ndaj urdhrit lidhur me këtë rast. Kjo nënkupton se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar që ndërlidhet drejtpërsëdrejti apo që rezulton nga konflikti i armatosur por për shkak të një kontrate të supozuar të shitblerjes e lidhur në mes të paraardhësit të tij S. (P.) R. dhe blerësit Sh. K., para konfliktit.

15. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se çështja nuk është në juridiksion të KKPK-së. Duke marrë parasysh se KKPK-ja vendosi mbi bazën e kërkesës, pavarësisht se i mungonte juridiksioni që nga humbja e posedimit të pronës së kërkuar nuk ka asnjë lidhje rastësore me konfliktin e armatosur, Gjykata Supreme konsideron se vendimi i kundërshtuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182 paragrafi 2 nën paragrafi (b) i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) e cila aplikohet mutatis mutandis në procedurën para, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut, e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Prandaj, vendimi i njëjtë i KKPK-së në pajtim me nenin 198 paragrafi 1 të LPK duhet të anulohet dhe kërkesa e paraqitësit të kërkesës të hedhet.

Këshillë ligjore:

19. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi , Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it